

KËSHILLI I EVROPËS

KËSHILLI I MINISTRAVE

Rekomandim (2006)² i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve¹

*(I miratuar nga Këshilli i Ministrave më 11 janar 2006
në takimin e 952-të të Zëvendës Ministrave)*

Këshilli i Ministrave, në bazë të Nenit 15.b të Statutit të Këshillit të Evropës,

Duke marrë parasysh Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

Duke marrë parasysh gjithashtu dhe punën e bërë nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues, dhe në veçanti standardet e përfshira në raportet e tij shpjeguese

Duke ritheksuar se askujt nuk duhet t'i hiqet liria, veçse si një opsion i fundit dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në ligj.

Duke theksuar se zbatimi i dënimeve me burgim dhe trajtimi i të burgosurve bëjnë të nevojshëm marrjen parasysh të kërkesave të sigurisë, sigurimit dhe disiplinës dhe krijimit të kushteve në burgje, të cilat nuk çenojnë dinjitetin njerëzor dhe ofrojnë programe punësimi dhe trajtimi për të burgosurit t për t'i përgatitur ata për ri-integrim në shoqëri;

Duke e konsideruar të rëndësishëm faktin që shtetet anëtare të Këshillit të Evropës vazhdojnë të rishikojnë dhe përmirësojnë parimet e përbashkëta në lidhje me politikën e tyre në fushën penitenciare.

Duke marrë gjithashtu në konsideratë që rishikimi i parimeve të tilla të përbashkëta do të rrisë bashkëpunimin ndërkombëtar në këtë fushë;

Duke vënë re ndryshimet domethënëse shoqërore që kanë patur ndikim të rëndësishme në fushën penale në Evropë gjatë dy dekadave të fundit;

Duke miratuar dhe një herë standardet që përfshihen në rekomandimet e Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës, të cilat lidhen me aspekte specifike të politikës dhe praktikës penitenciare dhe në veçanti Rekomandimin nr (89) 12 mbi arsimin në burgje, Rekomandimin nr (93) 6 që lidhet me aspektet e burgut dhe kriminalistikës së kontrollit të sëmundjeve të transmetueshme duke përfshirë AIDS-in dhe probleme të tjera shëndetësore në burgje, Rekomandimin nr (97) 12 mbi personelin që merret me zbatimin e sanksioneve dhe masave në komunitet, Rekomandimin nr (98) 7 lidhur me aspektet etike dhe organizative të kujdesit shëndetësor në burg, Rekomandimin nr (99) 22 që trajton mbipopullimin në burgje dhe inflacionin e popullsisë në burgje, Rekomandimi (2003)22 që trajton lirinë me kusht dhe Rekomandimin (2003)23 mbi menaxhimin nga administrata e burgjeve të dënuarve me burgim të përjetshëm dhe të burgosurve të tjerë të dënuar me periudhë të gjatë;

Duke pasur parasysh Rregullat Minimale Standarde të Kombeve të Bashkuara për Trajtimin e të Burgosurve;

¹ Kur u miratua ky rekomandim, dhe në zbatim të Nenit 10.2c të Rregullores mbi Procedurën e takimeve të Zëvendës Ministrave, përfaqësuesi i Danimarkës rezervoi të drejtën e qeverisë së tij për t'u përmbajtur ose jo Pikës 43, paragrafi 2 i shtojcës së rekomandimit pasi është e mendimit që kërkesa që të burgosurit e dënuar me qëndrimin të vetëm në qeli të vizitohen nga personeli mjekësor përditë ngre shqetësime serioze etike në lidhje me rolin e mundshëm të këtij personeli për t'u shprehur në menyrë të efektshme nëse i burgosuri është në gjëndje të vazhdojë të qendrojë i vetëm në qeli.

Duke ditur që Rekomandimi nr (87) 3 i Këshillit të Ministrave mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve ka nevojë për rishikim dhe përmirësim substancial në mënyrë që të reflektojnë zhvillimet që kanë ndodhur në politikën penale, praktikën e dënimit dhe menaxhimin e përgjithshëm të burgjeve në Evropë,

Rekomandon që qeveritë e shteteve anëtare:

- të reflektojnë në legjislacionin, politikat dhe praktikat e tyre rregullat që përfshihen në shtojcën e këtij rekomandimi, të cilat zëvendësojnë Rekomandimin nr (87) 3 të Këshillit të Ministrave mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve;
- të sigurohen që ky rekomandim dhe komentari shoqëruar i tekstit të tij të përkthehen dhe të shpërndahen sa më shumë të jetë e mundur, dhe veçanërisht t'u shpërndahen autoriteteve gjyqësore, personelit të burgjeve dhe të burgosurve.

Shtojca e Rekomandimit (2006)2

Pjesa I

Parimet Bazë

1. Personat, të cilëve u është mohuar liria, trajtohen me respekt ndaj të drejtave të tyre njerëzore.
2. Personat të cilëve u është mohuar liria, gëzojnë të gjitha të drejtat që nuk u janë marrë atyre në mënyrë të ligjshme nga vendimet që i dënojnë ata ose që i lënë në paraburgim.
3. Kufizimet për personat të cilëve u është mohuar liria ushtrohen në masën minimale të nevojshme dhe në përpjestim me objektivat legjitime për të cilat ato janë vendosur.
4. Kushtet në burg, që çenojnë të drejtat e njeriut të të burgosurve nuk justifikohen nga mungesa e burimeve.
5. Jeta në burg duhet të përafrohet sa më shumë të jetë e mundur me aspektet pozitive të jetës në komunitet.
6. E gjithë koha e ndalimit menaxhohet në mënyrë të tillë që të lehtësojë ri-integrimin në një shoqëri të lirë të personave të cilëve u është mohuar liria.
7. Bashkëpunimi me shërbime të jashtme shoqërore dhe përfshirja e shoqërisë civile në jetën e burgjeve inkurajohet sa më shumë të jetë e mundur.
8. Personeli i burgut kryen një shërbim të rëndësishëm publik. Marrja në punë, trajnimi dhe kushtet e punës së personelit të burgut duhet të mundësojnë aplikimin e standardeve të larta në kujdesin ndaj të burgosurve.
9. Të gjitha burgjet duhet të jenë subjekte të inspektimit të rregullt qeveritar dhe i monitorimit të pavarur.

Qëllimi dhe aplikimi

- 10.1 Rregullat Evropiane të Burgjeve zbatohen ndaj personave të cilët janë në paraburgim, në pritje të vendimit të organit gjyqësor ose ndaj atyre të cilëve u është mohuar liria pas dënimit.
- 10.2 Në parim, personat të cilët mbahen në paraburgim me vendim të një autoriteti gjyqësor dhe personat të cilëve u është hequr liria pas dënimit, mbahen vetëm në burgje, pra në institucione të rezervuara për të ndaluarit e këtyre dy llojve kategorive..
- 10.3 Rregullat zbatohet gjithashtu edhe edhe për personat:

- a. të cilet mund të mbahen në burg për një arsye tjetër ; ose
 - b. që mbahen në paraburgim me vendim të një autoriteti gjyqësor, ose u është hequr liria pas dënimit, dhe që, për ndonjë arsye, mund mbahen në një vend tjetër.
- 10.4 Personat të cilët vuajnë dënimin në burg ose që janë dënuar sipas mënyrës së parashikuar në paragrafin 10.3.b konsiderohen të burgosur për qëllimet e këtyre rregullave.
- 11.1 Të miturit nën moshën 18 vjeç nuk vuajnë dënimin në burgje për të rriturit, por në vende të posaçme të ndërtuara enkas për këtë qëllim.
- 11.2 Kur në raste përjashtimore të miturit mbahen në burgje të tilla, duhet të ketë rregulla të posaçme që trajtojnë statusin dhe nevojat e tyre.
- 12.1 Personat që vuajnë nga sëmundje mendore dhe shëndeti mendor i të cilëve nuk është i përshtatshëm me ndalimin në burg, vuajnë dënimin në një vend të ndërtuar posaçërisht për këtë kategori të dënuarish.
- 12.2 Kur këta persona në raste përjashtimore, mbahen në burgje duhet të ketë rregulla të posaçme që parashikojnë statusin dhe nevojat e tyre.
13. Këto rregulla zbatohen të plota, pa asnjë diskriminim seksi, rrace, ngjyre, gjuhe, feje, politik ose opinion tjetër, apo diskriminim me origjinë kombësie ose shoqërore, ne lidhje me një pakicë kombëtare, me pronen, me lindjen ose statuse të tjera.

Pjesa II

Kushtet e burgimit

Pranimi

14. Asnjë person nuk pranohet ose mbahet në burg si i burgosur pa një urdhër të vlefshëm burgimi, të lëshuar në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.
- 15.1 Në momentin e pranimi, regjistrohen menjëherë të dhënat e mëposhtëme për secilin të burgosur:
- a. informacion që lidhet me identitetin e të burgosurit;
 - b. arsyet e dënimit dhe autoriteti lëshues i tij;
 - c. data dhe ora e pranimi;
 - d. një inventar i sendeve personale të të burgosurit, të cilat mbahen në kasaforta sipas pikës 31;
 - e. çdo plagë e dukshme ose ankesë rreth keqtrajtimeve të mëparshme; dhe
 - f. çdo informacion mbi shëndetin e të burgosurit që ka lidhje me mirëqënien fizike dhe mendore të tij dhe të të tjerëve në bazë të kërkesave për mbajtjen e konfidencialitetit mjekësor,.
- 15.2 Në momentin e pranimi të burgosurve duhet t'u jepet informacion sipas pikës 30.
- 15.3 Menjëherë pas pranimi bëhet lajmërimi për ndalimin e të burgosurit në përputhje me pikën 24.6.
16. Menjëherë pas pranimi jepet:
- a. informacion në lidhje me shëndetin e të burgosurit në momentin e pranimi, i plotësuar nga analizat mjekësore në përputhje me pikën 42;
 - b. niveli i duhur i sigurisë së të burgosurit, i përcaktuar në përputhje me pikën 51;
 - c. kërcënimi që i burgosuri i sjell sigurisë, i përcaktuar në përputhje me pikën 52;
 - d. çdo informacion i disponueshëm mbi situatën shoqërore të të burgosurit, duhet vlerësuar në mënyrë që të merren menjëherë në konsideratë nevojat personale dhe të mirëqënies së të burgosurit; dhe

- e. në rastin e të burgosurve të dënuar, merren masat e nevojshme për të zbatuar programe në përputhje me Pjesën VIII të kësaj Rregullore.

Vendosja dhe strehimi

17.1 Të burgosurit vendosen, sipas mundësive, në burgjet afër vendbanimeve të tyre ose afër qendrave shoqërore të rehabilitimit.

17.2 Vendosja bëhet duke marrë parasysh edhe kërkesat për hetime të vazhdueshme mbi krimet, sigurinë, sigurimin dhe nevojat për t'u dhënë të burgosurve regjime të përshtatshme.

17.3 Të burgosurit konsultohen për atë që sa të jetë e mundur, për vendosjen e tyre fillestare dhe për transferimet e mëvonshme nga njëri burg në tjetrin.

18.1 Strehimi që u ofrohet të burgosurve dhe në veçanti fjetja respektojnë dinjitetin njerëzor, dhe, sa më shumë të jetë e mundur, privacinë si dhe plotësojnë kërkesat shëndetësore dhe higjienike, duke u kushtuar rëndësinë e duhur kushteve të klimës dhe veçanërisht hapsirës së dyshemesë, përmbajtjes kubike të ajrit, ndriçimit, ngrohjes dhe ajrimit.

18.2 Në mjediset ku të burgosurve u duhet të jetojnë, punojnë ose të rrinë sëbashku:

- a. dritaret duhet të jenë mjaftueshmërisht të mëdha për t'u lejuar atyre të lexojnë ose punojnë me dritën natyrore në kushte normale, dhe të lejojnë hyrjen e ajrit të pastër, me përjashtim të rasteve kur ekziston një sistem i përshtatshëm ajri të kondicionuar;
- b. drita artificiale duhet të plotësojë standardet e njohura teknike; dhe
- c. duhet të kenë një sistem alarmi që u lejon të burgosurve të kontaktojnë personelin e burgut pa vonesë.

18.3 Kërkesat specifike minimale në lidhje me çështjet që trajtohen nga paragrafët 1 dhe 2 parashikohen në legjislacionin vendas.

18.4 Legjislacioni vendas parashikon mekanizmat për t'u siguruar që këto kërkesa minimale nuk çënohen duke mbipulluar burgjet.

18.5 Të burgosurit strehohen normalisht gjatë natës në qeli individuale, në përjashtim të rasteve kur prej tyre preferohet që të ndajnë qelinë me dikë tjetër.

18.6 Strehimi do të jetë i përbashkët vetëm nëse mjedisi është i përshtatshëm për këtë qëllim dhe nëse në këtë mjedis qëndrojnë të burgosur që janë të përshtatshëm për njëri-tjetrin.

18.7 Të burgosurve u jepet mundësia të zgjedhin, për atë që sa të jetë e mundur, përpara se t'u kërkohet të strehohen/qëndrojnë në të njëjtin vend me të tjerë.

18.8 Gjatë marrjes së vendimit për të strehuar të burgosur në burgje të veçanta ose në seksione të veçanta të një burgu i jepet rëndësi nevojës për të:

- a. ndarë të burgosurit e pagjykuar nga të burgosurit e dënuar;
- b. të burgosurit meshkuj nga të burgosurat femra; dhe
- c. të burgosurit e rinj nga të burgosurit më të mëdhenj në moshë.

18.9 Bëhen përjashtime nga kërkesat për burgim të veçantë, të parashikuara në paragrafin 8, në mënyrë që të gjithë të burgosurve t'u bëhet e mundur të marrin pjesë bashkarisht në veprimtari të organizuara. Grupet shpërndahen gjithmonë gjatë natës, me përjashtim të rasteve kur ata japin pëlqimin që të qëndrojnë së bashku dhe kur organet e burgut gjykojnë se një veprim i tillë është në interes të të gjithë të burgosurve.

18.10 Strehimi i të burgosurve bëhet në përputhje me kushtet minimale kufizuese të sigurimit duke patur parasysh shmangien e mundësive arratisjen e të burgosurve ose dëmtimin e vetes ose të tjerëve.

Higjena

- 19.1 Të gjitha mjediset e çdo burgu duhet të mirëmbahen dhe të mbahen të pastra gjatë gjithë kohës.
- 19.2 Kur të burgosurit pranojnë në burg, qelitë ose mjediset e tjera ku ata qëndrojnë pastrohen rregullisht.
- 19.3 Të burgosurit kanë akses të rregullt në mjediset sanitare, të cilat duhet të jenë të pastra dhe të respektojnë privacinë.
- 19.4 Çdo të burgosuri duhet t'i sigurohen kushte të përshtatshme në mënyrë të tillë që të bëjë dush, me ujë në temperaturë të përshtatshme me klimën. Kur është e mundur dushi mund të bëhet çdo ditë, ose të paktën dy herë në javë (ose më shpesh nëse është e nevojshme) në interes të higjienës së përgjithshme.
- 19.5 Të burgosurit duhet të mbajnë veten, rrobat dhe shtresat e fjetjes të pastra dhe të rregullta.
- 19.6 Autoritetet e burgut duhet t'u ofrojnë atyre mjetet për të realizuar këto kushte, duke përfshirë dhënien e mjeteve të nevojshme të tualetit, si dhe materiale të përgjithshme pastrimi.
- 19.7 Për nevojat sanitare të grave nxirren dispozita të veçanta.

Rrobat dhe shtresat e fjetjes

- 20.1 Të burgosurit, kur nuk kanë rroba të përshtatshme të tyre, pajisen me rroba sipas klimës.
- 20.2 Këto rroba nuk duhet të jenë denigruese ose përbuzëse.
- 20.3 Rrobat duhet të mbahen mirë dhe të zëvendësohen kur të jetë e nevojshme.
- 20.4 Të burgosurve, kur marrin leje për të dalë nga burgu, nuk u kërkohet të veshin rroba që i identifikojnë ata si të burgosur.
21. Secili i burgosur pajiset me një shtrat vetiak dhe shtresa të veçanta dhe të përshtatshme për të. Këto duhet të mbahen në rregull dhe të ndërrohen shpesh për të siguruar pastërtinë e tyre.

Ushqimi

- 22.1 Të burgosurve u sigurohet një dietë ushqimi që merr parasysh moshën e tyre, shëndetin, kushtet fizike, fenë, kulturën dhe natyrën e punës që bëjnë.
- 22.2 Kërkesat e një diete ushqimi, duke përfshirë përmbajtjen minimale të energjisë dhe të proteinave, parashikohen në legjislacionin kombëtar.
- 22.3 Ushqimi përgatitet dhe shërbehet pastër.
- 22.4 Të burgosurve u ofrohen tre vakte në ditë, me intervale të arsyeshme ndërmjet tyre.
- 22.5 Uji i pijshëm i pastër është në dispozicion të të burgosurve gjatë gjithë kohës.
- 22.6 Kur diktohet nga kushtet shëndetësore eksperti mjekësor ose një infermiere e specializuar urdhërojnë ndryshimin e dietës për një të burgosur.

Këshillimi ligjor

- 23.1 Të burgosurit kanë të drejtë të marrin këshillim ligjor dhe organet e burgut duhet t'i pajisin ata me vende të arsyeshme ku mund të kenë akses në një këshillim të tillë

23.2 Për çdo çështje ligjore të burgosurit kanë të drejtë të konsultohen me një këshilltar ligjor të zgjedhur prej tyre dhe me shpenzimet e tyre.

23.3 Kur ka një skemë të njohur të ndihmës ligjore falas, organet e burgut ia bëjnë këtë gjë të ditur të burgosurve.

23.4 Kunsultimet dhe komunikimet e tjera, duke përfshirë dhe korrespondencën rreth çështjeve ligjore ndërmjet të burgosurve dhe këshilltarëve të tyre ligjorë, janë konfidenciale.

23.5 Në rrethana specifike, një organ gjyqësor autorizon kufizime mbi një konfidencialitet të tillë për të shmangur krimet e rënda ose cënimin e sigurisë dhe sigurimit në burg.

23.6 Të burgosurit kanë akses ose lejohen të mbajnë në pronësinë e tyre dokumenta që lidhen me procedurat e tyre ligjore.

Kontakti me botën e jashtme

24.1 Të burgosurit lejohen të komunikojnë sa më shpesh të jetë e mundur nëpërmjet letrave, telefonit ose formave të tjera të komunikimit me familjarët e tyre, persona të tjerë dhe përfaqësues të organizatave të jashtme dhe të presin vizita nga këta persona.

24.2 Komunikimi dhe vizitat mund të jenë subjekt i kufizimeve dhe vëzhgimit, për shkak të kërkesave që lidhen me vazhdimin e procesit hetimor, për ruajtjen e rregullit, sigurisë dhe sigurimit, për parandalimin e veprave penale dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, duke përfshirë kufizime të veçanta të autorizuar nga një organ gjyqësor, të cilat gjithsesi lejojnë një nivel minimal të pranueshëm kontakti.

24.3 Legjislacioni kombëtar specifikon organizmat kombëtare dhe ndërkombëtare të cilëve nuk iu kufizohet komunikimi me të burgosurit.

24.4 Organizimi i vizitave bëhet në mënyrë të tillë që të lejojë të burgosurit të mbajnë dhe të zhvillojnë marrëdhëniet familjare në mënyrën më normale të mundur.

24.5 Organet e burgut ndihmojnë të burgosurit të mbajnë kontaktet e duhura me botën e jashtme dhe i pajisin ata me mbështetjen e duhur për këtë gjë.

24.6 Çdo informacion i marrë mbi vdekjen ose një sëmundje serioze të një njeriu të afërt i komunikohet megjëherë të burgosurit.

24.7 Kur e lejojnë rrethanat, i burgosuri autorizohet të largohet nga burgu ose i shoqëruar me eskortë ose vetëm për të vizituar një të afërm të sëmurë, për të marrë pjesë në një varrim ose për arsye të tjera njerëzore.

24.8 Të burgosurit lejohen të njoftojnë menjëherë familjet e tyre për burgimin ose transferimin në një tjetër institucion dhe për çdo sëmundje ose plagosje serioze që mund t'u ndodhë.

24.9 Pas pranimit të një të burgosuri në burg, në rast vdekje ose sëmundje serioze, plagosje/dëmtim serioz ose transferimi të një të burgosuri në spital, organet e burgut informojnë menjëherë gruan ose burrin e të burgosurit, ose, në rast se i burgosuri është i pamartuar, personin më të afërt dhe çdo njeri tjetër të caktuar më parë nga i burgosuri. Përrjashtim bëjnë rastet kur i burgosuri u kërkon organeve të burgut të mos informojnë askënd.

24.10 Të burgosurit lejohen të jenë të informuar rregullisht për çështjet publike duke u abonuar dhe duke lexuar gazeta, periodikë dhe botime të tjera ose duke dëgjuar radion ose transmetimet televizive. Përrjashtim bëjnë rastet e ndalimeve të veçanta për një kohë të caktuar nga një organ gjyqësor për një çështje individuale.

24.11 Autoritetet e burgut sigurohen që të burgosurit të kenë mundësinë të marrin pjesë në zgjedhje, referendume dhe në aspekte të tjera të jetës publike për aq kohë sa e drejta e tyre për këto veprime nuk kufizohet nga legjislacioni kombëtar.

24.12 Të burgosurit lejohen të komunikojnë me median. Përfshirë bënë rastet kur ka arsye të forta për të mos lejuar këtë gjë për të ruajtjet e sigurisë dhe sigurimit, për interesin publik ose në mënyrë që të mbrohet integriteti i viktimave, i të burgosurve të tjerë ose i personelit të burgut.

Regjimi i burgut

25.1 Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit përfshin një program të balancuar veprimtarish.

25.2 Ky regjim u lejon të gjithë të burgosurve të harxhojnë sa më shumë orë në ditë jashtë qelive të tyre sipas nevojës për një nivel të përshtatshëm të ndërveprimit njerëzor dhe shoqëror.

25.3 Ky regjim parashikon dhe nevojat për mirëqenie të të burgosurve.

25.4 Një vëmendje e veçantë i kushtohet nevojave të të burgosurve që kanë qenë objekt i abuzimit fizik, mendor ose seksual.

Puna

26.1 Puna në burgje konsiderohet një element pozitiv i regjimit të burgjeve dhe nuk përdoret asnjëherë si ndëshkim.

26.2 Autoritetet e burgjeve duhet të përpiqen për të siguruar punë të mjaftueshme të një natyre të dobishme.

26.3 Puna e dhënë, për aq sa është e mundur, duhet të jetë e tillë sa të lejojë mbajtjen ose rritjen e mundësisë së të burgosurve për të siguruar jetën në liri nëpërmjet punës.

26.4 Në përputhje me pikën 13, nuk ka diskriminim për shkak të gjinisë në llojin e punës së dhënë.

26.5 Punët që përfshijnë trajnim profesional ofrohen për të burgosurit që janë në gjendje të përfitojnë prej tyre, duke u dhënë përparësi të veçantë të rinjve.

26.6 Të burgosurit mund të përzgjedhin llojin e punësimit që dëshirojnë, brenda kufinjve të asaj që është e disponueshme, përzgjedhjes së përshtatshme të profesionit dhe kërkesave për të mbajtur rregullin dhe disiplinën.

26.7 Organizimi dhe metodat e punës në institucione janë, sa më shumë të jetë e mundur, të ngjashme me të njëjtën punë në komunitet në mënyrë që të burgosurit të përgatiten për kushtet e një jete normale pune.

26.8 Megjithatë përfitimet financiare nga industritë në institucione mund të jenë të lidhura me rritjen e standardeve, cilësisë dhe përshtatshmërisë së trajnimit të ofruar, interesat e të burgosurve nuk duhet të varen nga ky qëllim.

26.9 Puna për të burgosurit jepet nga autoritetet e burgut, ose në bashkëpunim me kontraktorë privatë, brenda ose jashtë burgut.

26.10 Në të gjitha rastet puna e të burgosurve shpërblehet me pagesën e duhur.

26.11 Të burgosurit lejohen të harxhojnë të paktën një pjesë të fitimeve të tyre për përdorim për sende të miratuara dhe të dërgojnë një pjesë të fitimeve tek familjet e tyre.

26.12 Të burgosurit inkurajohen të kursejnë një pjesë të të ardhurave të tyre, të cilat do t'u kthehen në momentin e lirimit, ose do të përdoren për qëllime të tjera të miratuara.

26.13 Masat e sigurimit shëndetësor dhe teknik për të burgosurit duhet t'i mbrojnë ata në mënyrë të mjaftueshme dhe nuk duhet të jenë masa më pak rigorozë sesa masat e përdorura për punëtorët jashtë burgut.

26.14 Në raste të dëmtimeve të rënda, duke përfshirë sëmundjet profesionale, për të dëmshpërblyer të burgosurit ka dispozita të veçanta, kushtet e të cilave nuk janë më pak të favorshme sesa kushtet e parashikuara nga legjislacioni kombëtar për punëtorët jashtë burgut.

26.15 Orët maksimale të punës në ditë dhe në javë për të burgosurit përcaktohen në përputhje me legjislacionin vendas ose rregullat që rregullojnë punësimin e punëtorëve të lirë.

26.16 Të burgosurit kanë të paktën një ditë pushimi në javë dhe kohë të mjaftueshme për arsimim dhe veprimtari të tjera.

26.17 Të burgosurit të cilët punojnë, për aq sa të jetë e mundur, përfshihen në sistemet e sigurimeve shoqërore.

Veprimet dhe veprimtaritë në kohën e lirë

27.1 Çdo i burgosur ka të drejtën e të qëndruar për të paktën një orë në ditë jashtë, në ajër të pastër, nëse kushtet e motit e lejojnë një gjë të tillë.

27.2 Kur moti është i papërshatshëm, ofrohen mundësi alternative për të lejuar të burgosurit që të ushtrojnë këtë të drejtë.

27.3 Veprimtaritë e organizuara për të zhvilluar formën fizike dhe për të ofruar mundësi të përshtatshme për ushtrime ose aktivitete gjatë kohës së lirë, përbëjnë një pjesë të rëndësishme të regjimeve të burgjeve.

27.4 Autoritetet e burgut ndihmojnë për të mundësuar veprimtari të tilla duke ofruar instalimet dhe pajisjet e nevojshme.

27.5 Autoritetet e burgut bëjnë organizojnë veprimtari të veçanta për të burgosurit që kanë nevojë për to.

27.6 Të burgosurve iu lejohet të organizojnë veprimtari për kalimin e kohës së lirë, për aq sa është e mundur. Këtu përfshihen sportet, lojrat, aktivitetet kulturore, hobet dhe aktivitete të tjera për të burgosurit.

27.7 Të burgosurit lejohen të shoqërohen me njëri-tjetrin gjatë veprimtarive në mënyrë që të marrin pjesë bashkarisht në veprimtari që organizohen gjatë kohës së lirë.

Arsimimi

28.1 Çdo burg duhet t'u japë të gjithë të burgosurve të drejtën për të marrë pjesë në programe edukative të cilat janë të kuptueshme dhe plotësojnë nevojat individuale duke marrë parasysh aspiratat e tyre.

28.2 Përparësi u jepet të burgosurve që kanë probleme me shkrimin dhe numërimin dhe atyre që nuk kanë arsim bazë ose profesional.

28.3 Vëmendje e veçantë i kushtohet arsimimit të të burgosurve në moshë të re dhe të burgosurve me nevoja të veçanta.

28.4 Arsimimi nuk ka më pak rëndësi sesa puna brenda regjimit të burgut dhe të burgosurit nuk kanë disavantazhe financiare ose disavantazhe të tjera kur marrin pjesë në procesin arsimor.

28.5 Çdo institucion ka një bibliotekë, e cila përdoret nga të gjithë të burgosurit, të pasigjur ashtu siç duhet me mjete edukative dhe çlodhëse, libra dhe media të ndryshme.

28.6 Kur është e mundur, biblioteka e burgut organizohet në bashkëpunim me shërbimet e bibliotekës së komunitetit.

28.7 Aq sa të jetë praktike, arsimimi i të burgosurve:

- a. integrohet me sistemin arsimor dhe sistemin e trajnimit profesional të vendit në mënyrë që pas lirimit të tyre ata të mund të vazhdojnë arsimimin dhe trajnimin profesional pa vështirësi; dhe
- b. zhvillohet nën vëzhgimin e institucioneve të jashtme arsimore.

Liria e mendimit, ndërgjegjja dhe feja

29.1 Të drejtat e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë të të burgosurit duhet të respektohen.

29.2 Regjimi i burgut organizohet, aq sa të jetë e mundur, në mënyrë të tillë që t'u lejojë të burgosurve të ushtrojnë fenë e tyre, të ndjekin besimet e tyre, të marrin pjesë në shërbime ose takime të drejtuara nga përfaqësues të miratuar nga fe ose besime të tilla, të presin vizita private nga përfaqësues të feve ose besimeve të ndryshme dhe të kenë në zotërim libra ose literaturë që lidhet me besimin ose fenë e tyre.

29.3 Të burgosurit nuk detyrohen të praktikojnë një fe ose besim, të ndjekin shërbime fetare ose takime, të marrin pjesë në praktika fetare ose të presin vizita nga përfaqësues të një feje ose besimi.

Informacioni

30.1 Të burgosurit, gjatë pranimit dhe kur është e nevojshme dhe më pas, njoftohen me shkrim dhe me gojë në një gjuhë të kuptueshme prej tyre për rregullat dhe disiplinën në burgje dhe për të drejtat dhe detyrimet e tyre gjatë kohës së qëndrimit në burg.

30.2 Të burgosurit lejohen të mbajnë një version të shkruar të informacionit që u është dhënë.

30.3 Të burgosurit njoftohen për çdo procedurë ligjore në të cilën ata janë të përfshirë, dhe, nëse janë të dënuar, njoftohen për kohën që duhet të shërbejnë dhe mundësitë për lirim më të shpejtë.

Sendet në zotërim të të burgosurve

31.1 Sendet e të burgosurve, që nuk mund të mbahen prej tyre, në bazë të rregullave të burgut, vendosen në kutitë e sigurisë menjëherë pas pranimit të tyre në institucion.

31.2 Një i burgosur sendet e së cilit janë vendosur në kutinë e sigurimit nënshkruan një inventar për to.

31.3 Për të mbajtur sendet e të burgosurve në kushte të mira merren masat e nevojshme.

31.4 Nëse është gjykuar e nevojshme që të shkatërrohen sendet e të burgosurit, ky akt regjistrohet dhe të burgosurit i jepet informacioni përkatës.

31.5 Të burgosurit, në bazë të kërkesave të higjenes, rregullit dhe sigurimit, kanë të drejtë të blejnë ose të marrin mallra, duke përfshirë dhe ushqime ose pije për përdorim personal me çmime të cilat nuk janë shumë më të larta se çmimet e mallrave jashtë burgut.

31.6 Nëse ndonjë i burgosur sjell medikamente, eksperti mjekësor vendos për mënyrën e përdorimit të tyre.

31.7 Kur të burgosurit lejohen të mbajnë në zotërimin e tyre sendet përkatëse, autoritetet e burgut marrin masa për ruajtjen e tyre.

Transferimi i të burgosurve

32.1 Kur të burgosurit transferohen nga një burg në tjetrin, ose lëvizin nga burgu në vende të tjera, si për shembull në gjykatë ose në spital, ata ekspozohen ndaj publikut sa më pak të jetë e mundur dhe merren masat e nevojshme për të ruajtur anonimin e tyre.

32.2 Ndalohet transportimi i të burgosurve me mjete pa ajrim të mjaftueshëm ose me dritë të papërshtatshme, ose që u shkaktojnë atyre vështirësi të panevojshme fizike ose cënim dinjiteti.

32.3 Transportimi i të burgosurve realizohet me shpenzimet dhe nën drejtimin e autoriteteve publike.

Lirimi i të burgosurve

33.1 Të gjithë të burgosurit lirohen pa vonese kur skadojnë urdhrat e dënimit ose në rast se një gjykatë ose një autoritet tjetër përkatës urdhëron lirimin e tyre.

33.2 Data dhe ora e lirit mbahen shënim.

33.3 Të gjithë të burgosurit përfitojnë nga planet që i ndihmojnë ata për t'u kthyer në shoqërinë e lirë pas lirit.

33.4 Pas lirit të një të burgosuri, të gjitha sendet dhe paratë që i përkasin atij dhe që u mbajtën të ruajtura i kthehen atij, në përjashtim të rasteve kur ka pasur tërheqje të autorizuar të parave ose dërgime të autorizuar të sendeve të tilla jashtë institucionit, ose nëse është parë si e nevojshme që të shkatërrohet çdo send për arsye higjienike.

33.5 I burgosuri nënshkruan një faturë për gjërat që i kthehen.

33.6 Kur liri është i paraplanifikuar, të burgosurit i ofrohet vizitë mjekësore në përputhje me pikën 42, sa më afër kohës së lirit që të jetë e mundur.

33.7 Në momentin e lirit merren masat e nevojshme që të burgosurit të pajisen, sipas nevojës, me dokumentat e duhura dhe me dokumentat e identifikimit, dhe të ndihmohen për të gjetur strehim dhe punë të përshtatshme.

33.8 Të burgosurit e liruar pajisen me mjetet e domosdoshme të jetesës, vishen mjaftueshëm dhe në mënyrë të përshtatshme në varësi të klimës dhe të sezonit, dhe u jepen mjetet e mjaftueshme për të arritur destinacionin e tyre.

Femrat

34.1 Përveç dispozitave të veçanta të këtyre rregullave që merren me të burgosurat femra, organet e burgut i kushtojnë vëmendje të veçantë kërkesave të grave, si për shembull nevojave të tyre fizike, profesionale, sociale dhe psikologjike kur merren vendime që prekin ndonjë aspekt të ndalimit të tyre.

34.2 Përpjekje të veçanta bëhen për të ofruar shërbime të posaçme për të burgosurat femra, të cilat kanë nevojat e parashikuara në pikën 25.4.

34.3 Të burgosurat lejohen të lindin jashtë burgut, por në rastet kur fëmija lind të burg, organet përkatëse japin të gjithë mbështetjen dhe lehtësitë e nevojshme.

Të miturit e ndaluar

35.1 Në rate të vecanta, kur të miturit nën moshën 18 vjeç mbahen të ndaluar në një burg për të rritur, autoritete e burgut sigurohen që përveç shërbimeve që janë të disponueshme për të burgosurit, të burgosurit e mitur të kenë akses në shërbimet shoqërore, psikologjike dhe edukative, kujdesin fetar dhe programet argëtuese ose programe të tjera ekuivalente me to që janë të disponueshme për fëmijët në komunitet.

35.2 Çdo i burgosur që është i mitur dhe është subjekt i arsimit të detyrueshëm ka akses në arsim.

35.3 Të miturit që janë liruar nga burgu përfitojnë asistencë shtesë.

35.4 Kur të burgosurit e mitur e vuajnë dënimin bashkë me të rriturit, të miturit mbahen në një pjesë të burgut që është e ndarë nga pjesa e përdorur nga të rriturit, me përjashtim të rasteve kur kjo ndarje konsiderohet në kundërshtim me interesat e të miturit.

Fëmijet

36.1 Fëmijet mund të rrinë në burg me një privatëm në rastet kur kjo gjë është në interesin më të mirë të fëmijes në fjalë. Ata nuk trajtohen si të burgosur.

36.2 Në rastet kur një fëmijë lejohet të rrijë në burg me një prind, përgatiten kushte të veçanta për ushqimin nga një personel i kualifikuar, gjatë kohës që atij i duhet të qëndrojë me personelin përkatës kur prindi është i përfshirë në veprimtari në të cilat i fëmija nuk duhet të jetë i pranishëm.

36.3 Strehimi për të miturit planifikohet më vete për të siguruar mirëqënien e tij.

Nënshtetasit e huaj

37.1 Të burgosurit që janë nënshtetas të huaj informohen, pa vonesë, mbi të drejtat e tyre për të kërkuar kontakt dhe për të lejuar përdorimin e mjeteve të arsyeshme të komunikimit me përfaqësuesit diplomatikë ose konsullorë të shtetit të tyre.

37.2 Të burgosurit që janë nënshtetas të vendeve që nuk kanë përfaqësi diplomatike ose konsullore në vendin e burgimit, refugjatët ose personat pa shtetësi lejohen të përdorin mjete të ngjashme për të komunikuar me përfaqësuesin diplomatik të shtetit që është përgjegjës për të mbrojtur interesat e tyre ose me autoritetin kombëtar ose ndërkombëtar që ka për detyrë t'i shërbejë interesave të personave të tillë.

37.3 Në interes të nënshtetasve të huaj, të cilët mund të kenë nevoja të veçanta në burg, autoritetet e burgut bashkëpunojnë plotësisht me zyrtarët diplomatikë dhe konsullorë që përfaqësojnë të burgosurit.

37.4 Për të burgosurit që kanë nënshtetësi të huaj ofrohet informacion i veçantë rreth ndihmës ligjore.

37.5 Të burgosurit që janë nënshtetas të huaj informohen për mundësinë për të kërkuar transferimin e ekzekutimit të dënimit në një vend tjetër.

Pakicat etnike ose gjuhësore

38.1 Për të plotësuar nevojat e të burgosurve që i përkasin pakicave etnike ose gjuhësore bëhen rregullime të veçanta.

38.2 Praktikrat kulturore të grupeve të ndryshme lejohen të ushtrohen në burg për aq kohë sa të jetë praktike.

38.3 Nevojat gjuhësore plotësohen duke përdorur përkthyes kompetentë dhe duke ofruar një material të shkruar për llojin e gjuhëve të përdorura në një burg të veçantë.

Pjesa III

Shëndeti

Kujdesi shëndetësor

39. Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë lënë në kujdesin e tyre.

Organizimi i kujdesit shëndetësor në burg

40.1 Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit.

40.2 Politika shëndetësore në burg integrohet në politikat kombëtare shëndetësore dhe është në përputhje me to.

40.3 Të burgosurit kanë akses në shërbimet shëndetësore që janë të disponueshme në komunitet pa u diskriminuar nga situata e tyre ligjore.

40.4 Shërbimet mjekësore në burg synojnë që të zbulojnë dhe trajtojnë sëmundje fizike ose mendore ose defekte nga të cilat mund të vuajnë të burgosurit.

40.5 Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet.

Personeli mjekësor dhe i kujdesit shëndetësor

41.1 Çdo i burgosur përfiton të paktën shërbimin e një mjeku të përgjithshëm të kualifikuar.

41.2 Në raste emergjencash duhet të planifikohet që gjatë të gjithë kohës të ketë një mjek të përgjithshëm të kualifikuar të disponueshëm..

41.3 Në rastet kur burgu nuk ka një mjek që punon me kohë të plotë, të burgosurit vizitohen rregullisht nga një mjek që punon me kohë të pjesshme.

41.4 Çdo burg ka personel të kualifikuar për kujdesin shëndetësor.

41.5 Shërbimet e dentistëve të kualifikuar i ofrohen çdo të burgosuri.

Detyrat e mjekut

42.1 Mjeku i burgut ose një infermiere e specializuar që i raporton atij takon çdo të burgosur sa më shpejt të jetë e mundur pas ardhjes në burg dhe i viziton ata, me përjashtim të rasteve kur një gjë e tillë është dukshëm e panevojshme.

42.2 Mjeku i burgut ose infermierja e kualifikuar që i raporton mjekut e viziton të burgosurin kur ai lirohet sipas kërkesës, dhe viziton të burgosurit e tjerë kurdo që është e nevojshme.

42.3 Kur viziton një të burgosur, mjeku ose infermierja e kualifikuar i kushton vëmendje të veçantë:

- a. rregullave të përgjithshme të konfidencialitetit mjekësor;
- b. diagnostifikimit të sëmundjeve mendore dhe marrjes së masave të nevojshme për trajtimin e tyre, dhe vazhdueshmërisë së trajtimit mjekësor;
- c. mbajtjes shënim dhe raportimit të çdo shenje ose treguesi që dëshmon se i burgosuri është trajtuar dhunshëm nga autoritetet përkatëse;
- d. trajtimit të simptomave që vijnë si rezultat i përdorimit të drogës, medikamenteve ose alkoolit;
- e. identifikimit të stresit psikologjik, ndonjë stresi tjetër ose stresit të shkaktuar nga privimi i lirisë;
- f. izolimit të të burgosurve që dyshohen për infeksione ose sëmundje ngjitëse gjatë periudhës së infeksionit dhe ofrimit të trajtimit të duhur për ta;
- g. sigurimit që të burgosurit që janë mbartës të virusit HIV nuk janë të izoluar vetëm për atë arsye;
- h. vënies në pah të defekteve fizike ose mendore që mund të pengojnë riadaptimin pas lirimit;
- i. përcaktimit të aftësisë së çdo të burgosuri për të punuar ose bërë ushtrime; dhe
- j. organizimet me agjencitë komunitare për vazhdimësinë e trajtimit të nevojshëm mjekësor dhe psikiatrik pas lirimit, nëse merret pëlqimi i të burgosurve për këtë veprim.

43.1 Mjeku i burgut kujdeset për shëndetin fizik dhe mendor të të burgosurve, sipas kushteve dhe aq herë sa është në përputhje me standardet e kujdesit shëndetësor në komunitet dhe viziton të gjithë të burgosurit e sëmurë, të gjithë ata që rezultojnë të sëmurë ose të dëmtuar dhe çdo të burgosur që kërkon vëmendje të veçantë.

43.2 Mjeku i burgut ose infermierja e specializuar që i raporton atij i kushton vëmendje të veçantë shëndetit të të burgosurve që mbahen të vetëm në qeli, i vizitojnë ata çdo ditë dhe u ofrojnë atyre ndihmën e duhur mjekësore dhe trajtimin përkatës sipas kërkesës së tyre ose të personelit të burgut.

43.3 Mjeku i burgut i raporton drejtorit për ratet kur mendohet se shëndeti fizik ose mendor i një të burgosuri është në rrezik nga burgimi i vazhdueshëm ose nga ndonjë arsye tjetër, duke përfshirë dhe kushtet e izolimit të një të burgosuri.

44. Mjeku i burgut ose një organ tjetër përgjegjës inspekton, mbledh informacion në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet mjeteve të tjera nëse është e nevojshme dhe këshillon drejtorin për:

- a. masën, cilësinë, përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit dhe të ujit;
- b. higjenën dhe pastërtinë e institucionit dhe të burgosurve;
- c. higjenën, ngrohjen, ndriçimin dhe ajrimin e institucionit; dhe
- d. përshtatshmërinë dhe pastërtinë e robave dhe shtresave të të burgosurve.

45.1 Drejtori merr në shqyrtim raportet dhe këshillon mjekun e përgjithshëm ose autoritetin përkatës të realizojë veprimet e parashikuara nga pika 43 dhe 44, dhe, kur është dakort me rekomandimet e bëra, merr masa të menjëhershme për t'i zbatuar ato.

45.2 Kur rekomandimet e mjekut të burgut nuk janë në kompetencë të drejtorit për t'u zbatuar, ose kur drejtori nuk është dakort me to, ai ia dërgon menjëherë këshillimet e mjekut të burgut dhe një raport personal një organi më të lartë.

Dispozitat për kujdesin shëndetësor

46.1 Të sëmurët që kërkojnë trajtim të specializuar transferohen në institucionet e specializuara, ose në spitale civile në rastet kur shërbimi i nevojshëm nuk ofrohet në burg..

46.2 Në rastet kur administrata e burgjeve ka spitalin e tij, spitali duhet të ketë personel të mjaftueshëm dhe pajisjet e nevojshme për të trajtuar të burgosurit që kanë nevojë për kujdes dhe trajtim.

Shëndeti mendor

47.1 Burgje ose seksione të specializuara nën kontrollin mjekësor janë të disponueshme për vizitat dhe trajtimin e të burgosurve që vuajnë nga çrregullimet mendore ose anormalitetet të cilat jo domosdoshmërisht parashikohen nga pika 12.

47.2 Shërbimi mjekësor i burgut ofron trajtimin psikiatrik për të burgosurit që kanë nevojë për të dhe i kushtojnë vëmendje parandalimit të vetëvrasjes.

Çështje të tjera

48.1 Të burgosurit nuk janë subjekt i asnjë eksperimenti pa pëlqimin e tyre.

48.2 Ndalohen experimentet që përfshijnë të burgosurit dhe që mund të shkaktojnë dëmtime fizike, çrregullime mendore ose dëmtime të tjera shëndetësore.

Pjesa IV

Rregulli në burg

Vështrim i përgjithshëm për mbajtjen e rregullit

49. Rregulli në burg mbahet duke marrë parasysh kërkesat për sigurim, siguri dhe disiplinë, ndërkohë që të burgosurve u ofrohen kushte jetese që respektojnë dinjitetin njerëzor dhe i pajisin ata me një program të plotë aktivitetesh, siç parashikohet në pikën 25.

50. Subjekt i nevojave për rregull, sigurim dhe siguri, të burgosurit lejohen të diskutojnë çështje që lidhen me kushtet e përgjithshme të burgimit dhe inkurajohen të komunikojnë me organet e burgut për këto çështje.

Sigurimi

51.1 Masat e sigurimit që aplikohen për të burgosur individë janë masat minimale të mundshme për të pasur një ndalim të sigurtë.

51.2 Sigurimi që realizohet nëpërmjet pengesave fizike dhe mjeteve të tjera teknike plotësohet nga sigurimi dinamik i ofruar nga personeli që është në gatishmëri, i cili i njeh të burgosurit që janë nën kontrollin e tyre.

51.3 Menjëherë pas pranimit, të burgosurit duhet të vlerësohen për të përcaktuar rrezikun:

- a. që paraqesin për komunitetin në rast se arratisen
- b. në rast se ata përpiqen të arratisen vetë ose me ndihmën e të tjerëve.

51.4 Më pas, çdo i burgosur mbahet në kushte sigurimi që u përkohet niveleve të rrezikut që ata paraqesin.

51.5 Niveli i nevojshmëri të sigurimit rishikohet në intervale të rregullta gjatë të gjithë kohës së burgimit të një personi.

Siguria

52.1 Sapo të jetë e mundur pas pranimit, të burgosurit vlerësohen për të përcaktuar nëse ata përbëjnë një rrezik sigurie për të burgosur të tjerë, për personelin e burgut ose për persona të tjerë që punojnë ose vizitojnë burgun, ose nëse ka gjasa që ata të dëmtojnë veten.

52.2 Ka norma procedurale për të garantuar sigurinë e të burgosurve, personelit të burgut dhe vizitorëve në burgje dhe për të ulur në minimum rrezikun e dhunës dhe ngjarje të tjera që kërcënojnë sigurinë.

52.3 Për të lejuar të burgosurit të marrin pjesë plotësisht në veprimtari ditore të sigurta bëhet çdo përpjekje e mundshme.

52.4 Të burgosurit janë në gjendje të kontaktojnë personelin e burgut gjatë të gjithë kohës, duke përfshirë edhe natën.

52.5 Në burgje zbatohen ligjet kombëtare për shëndetin dhe sigurinë.

Masa të posaçme sigurimi dhe sigurie të lartë

53.1 Masat e posaçme të sigurisë dhe sigurimit të lartë merren vetëm në raste përjashtimore.

53.2 Në rast aplikimi të masave të tilla ka procedura të qarta.

53.3 Natyra e këtyre masave, kohëzgjatja dhe kushtet në të cilat aplikohen ato përcaktohen në legjislacionin kombëtar.

53.4 Aplikimi i masave për secilin rast miratohet nga organi kompetent për një periudhë të caktuar kohe.

53.5 Çdo vendim për të shtyrë periudhën e miratuar është subjekt i një miratimi të ri nga organi kompetent.

53.6 Masa të tilla aplikohen për individët dhe për grupe të burgosurish.

53.7 Çdo i burgosur që është subjekt i këtyre masave ka të drejtën e ankimit, sipas parashikimeve të dhëna në pikën 70.

Kërkimi dhe kontrollet

54.1 Në raste kontrolli, ka procedura të veçanta që ndiqen nga personeli. Kontrollohen:

- a. të gjitha vendet ku jetojnë, punojnë dhe rrinë sëbashku të burgosurit;
- b. të burgosurit;
- c. vizitorët dhe sendet e tyre; dhe
- d. personeli.

54.2 Situatat kur janë të nevojshme këto kontrolle dhe natyra e tyre parashikohen nga legjislacioni kombëtar.

54.3 Personeli trajnohet për të qënë i aftë të realizojë këto kontrolle në mënyrë që të zbulojë dhe të parandalojë përpjekjet për të shpëtuar nga kontrabanda ose për t'iu fshehur asaj, ndërkohë që respektohet dinjiteti i personave mbi të cilët kryhet kontrolli dhe sendet personale të tyre.

54.4 Gjatë procesit të kontrollit, personat që janë subjekt i tij nuk duhet të trajtohen pa dinjitet.

54.5 kontrolli ushtrohet vetëm nga personel i së njëjtës gjini.

54.6 Personeli i burgut nuk bën kontrolle të brendshme fizike në trupin e të burgosurve.

54.7 Një kontroll intim i lidhur me kërkimin bëhet vetëm nga mjeku i burgut.

54.8 Të burgosurit janë të pranishëm kur kërkohet në sendet e tyre personale, në përjashtim të rasteve kur prania e tyre nuk lejohet nga teknikat e investigimit ose kërcënimet e mundshme ndaj stafit.

54.9 Detyrimi për të mbrojtur sigurimin dhe sigurinë balancohen me privatesinë e vizitorëve.

54.10 Procedurat për kontrollin e vizitorëve profesionistë, si për shembull përfaqësuesit ligjorë, punonjësit socialë dhe mjekët e burgut etj. janë subjekt i konsultimeve me organet përkatëse profesionale për të siguruar një balancë ndërmjet sigurimit dhe sigurisë, dhe të drejtës së aksesit profesional konfidencial.

Veprat penale

55. Hetimet mbi një vepër penale të dyshuar se ka ndodhur në burg zhvillohen në të njëjtën mënyrë në burg si në shoqërinë e lirë dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin kombëtar.

Disiplina dhe dënimi

56.1 Procedurat disiplinore janë mekanizma të fundit.

56.2 Kur është e mundur, organet e burgut përdorin mekanizma ndreqje dhe ndërmjetësimi për të zgjidhur mosmarrëveshjet ndërmjet të burgosurve.

57.1 Vetëm sjelljet që kanë të ngjarë të përbëjnë kërcënim për rregullin, sigurimin dhe sigurinë mund të përcaktohen si shkelje disiplinore.

57.2 Legjislacioni kombëtar përcakton:

- a. aktet ose veprimet e gabuara të kryera nga të burgosurit dhe që përbëjnë shkelje disiplinore;
- b. procedurat që do të ndiqen në seanca dëgjimore disiplinore;
- c. llojet dhe zgjatjen e dënimit që mund të jepet për të burgosurin;
- d. autoritetin kompetent për të vendosur dënimin; dhe
- e. aksesin në organin e procesit të apelit.

58. Çdo akuzë për thyerje të rregullave disiplinore nga një i burgosur do t'i raportohet menjëherë organit përkatës, i cili bën hetimet pa vonese.

59. Të burgosurit e akuzuar për shkelje disiplinore:

- a. informohen menjëherë në një gjuhë që është e kuptueshme prej tyre dhe njihen në detaje me akuzat e ngritura kundër tyre;
- b. marrin kohë dhe mjete të mjaftueshme për t'u përgatitur për mbrojtjen;
- c. lejohen që të mbrojnë veten personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore kur kërkohet nga interesat e drejtësisë;
- d. lejohen të kërkojnë pjesëmarrjen e dëshmitarëve dhe të bëjnë shqyrtime vetë, ose nga të tjetër në emër të tyre; dhe
- e. përfitojnë ndihmën falas të një përkthyesi nëse ata nuk kuptojnë ose flasin gjuhën e përdorur në seanca.

60.1 Çdo dënim i dhënë pas kryesjes së një shkelje disiplinore është në përputhje me legjislacionin kombëtar.

60.2 Shkalla e dënimit është në përputhje me shkeljen e bërë.

60.3 Dënimet kolektive dhe dënimet trupore, dënimi me vendosjen në një qeli ne errësirë si dhe çdo formë tjetër dënimi çnjerëzor ose degradues janë të ndaluara.

60.4 Dënimi nuk përfshin ndalimin e plotë të kontakteve me familjen.

60.5 Dënimi me qendrim i vetëm në qeli aplikohet vetëm në raste përjashtimore dhe për një periudhë të caktuar kohe, e cila duhet të jetë sa më e shkurtër që të jetë e mundur.

60.6 Mjetet kufizuese nuk përdoren kurrë si dënime.

61. Një i burgosur që është fajtor për një shkelje disiplinore ka të drejtën që të apelojë tek një organ më i lartë kompetent dhe i pavarur.

62. Asnjë te burgosuri që ka kryer shkelje disiplinore nuk i jepet punë ose ndonjë autoritet në burg si masë ndëshkuese

Gjykimi i dyfishtë

Asnjë i burgosur nuk dënohet dy herë për të njëjtin akt ose të njëjtën sjellje.

Përdorimi i forcës

64.1 Personeli i burgut nuk përdor forcë kundër të burgosurve, me përjashtim të rasteve kur ky veprim është i nevojshëm për vetëmbrojtje ose në rast të tentativave për arratisje, rezistencë aktive ose pasive ndaj një urdhri të ligjshëm; edhe në këto raste forca përdoret si mjet i fundit.

64.2 Masa e forcës së përdorur është minimumi i mundshëm dhe përdoret në kohën më të shkurtër të mundshme.

65. Ka procedura të detajuara për përdorimin e forcës, duke përfshirë dipozita rreth:

- a. llojeve të ndryshme të forcës që mund të përdoret;
- b. rrethanat në të cilat përdoret secila lloj force;
- c. anëtarët e personelit që kanë të drejtë të përdorin lloje të ndryshme force;
- d. niveli i pozitës që kërkohet përpara përdorimit të çdo lloj force; dhe
- e. raportet që duhet të plotësohen pas përdorimit të forcës.

66. Personeli që merret drejtpërsëdrejti me të burgosurit trajnohet për teknikat që bëjnë të mundur përdorimin minimal të forcës për të kthyer vetëkontrollin tek të burgosurit agresivë.

67.1 Personeli i agjencive të tjera të zbatimit të ligjit përfshihet në trajtimin e të burgosurve brenda burgjeve në raste të veçanta.

67.2 Duhet të ketë një marrëveshje zyrtare ndërmjet autoriteteve të burgut dhe ndonjë agjencie për zbatimin e ligjit, në përjashtim të rasteve kur marrëdhënia regullohet nga legjislacioni vendas.

67.3 Një marrëveshje e tillë parashikon:

- a. kushtet në të cilat anëtarë të tjerë të agjencive të zbatimit të ligjit mund të hyjnë në burg për të trajtuar konflikte;
- b. masën e të drejtave që kanë agjencitë për zbatimin e ligjit ndërkohë që ato janë brenda burgut dhe marrëdhënia me drejtorin e burgut;
- c. llojet e ndryshme të forcës që përdorin anëtarë të agjencive të tilla;
- d. rrethanat në të cilat përdoret secila lloj force;
- e. nivelin e nevojshëm të kompetencave përpara se të përdoret forca; dhe
- f. raportet që duhet të përgatiten pas përdorimit të forcës.

Instrumentat e kufizimeve

68.1 Ndalohet përdorimi i zinxhirëve dhe i hekurave.

68.2 Prangat e duarve, xhaketat e dënimit dhe gjëra të tilla të rënda trupore kufizuese nuk përdoren me përjashtim të rasteve kur:

- a. ato janë të nevojshme për të parandaluar arratisjen gjatë një transferimi, me kusht që ato të hiqen kur i burgosuri del përpara një organi gjyqësor ose administrativ, në përjashtim të rasteve kur organet vendosin ndryshe; ose kur
- b. jep urdhër drejtori, në rastet kur metoda të tjera kontrolli dështojnë, në mënyrë që të mbrohet i burgosuri nga vetëdëmtimi, dëmtime të tjerëve ose për të parandaluar dëmtime serioze ndaj pronës; në këto raste drejtori informon menjëherë mjekun e burgut dhe i raporton një organi më të lartë.

68.3 Instrumentet e tilla nuk përdoren më gjatë sesa është jashtëzakonisht e nevojshme.

68.4 Mënyra e përdorimit të instrumentave të tilla specifikohet në legjislacionin e brendshëm.

Armët

69.1 personeli i burgut, përveç rasteve të operacioneve emergjente, nuk mban brenda perimetrit të burgut armë vdekjeprurëse.

69.2 Mbajtja e lirë e armëve të tjera, duke përfshirë shkopinj të gomës, nga personat në kontakt me të burgosurit ndalohet brenda perimetrit të burgut, me përjashtim të rasteve kur ato nevojiten për sigurinë dhe sigurimin në burg në mënyrë që të trajtohet një incident i veçantë.

69.3 Personeli nuk pajiset me armë nëse ai nuk është trajnuar për përdorimin e tyre.

Kërkesat dhe ankesat

70.1 Të burgosurit, qoftë individualisht ose në grup, kanë mundësi të mjaftueshme për të bërë kërkesa ose ankesa për drejtorin e burgut, ose për ndonjë organ tjetër kompetent.

70.2 Kur është e mundur, së pari duhet të përdoret ndërmjetësimi.

70.3 Kur mohohet një kërkesë ose kundërshtohet një ankesë, të burgosurit i jepen arsyet për të dyja rastet, dhe, nga ana e tij, i burgosuri ka të drejtë të apelojë tek autoriteti përkatës.

70.4 Të burgosurit nuk dënohen sepse kanë bërë një kërkesë ose depozituar një ankesë.

70.5 Organi kompetent merr parasysh çdo ankesë të shkruar nga të afërmit e një të burgosuri kur ata kanë arsye për të besuar se janë shkelur të drejtat e një të burgosuri.

70.6 Një përfaqësues ligjor ose një organizatë nuk mund të sjellë në emër të burgut një ankesë lidhur me mirëqënien e të burgosurve nëse nuk merret pëlqimi i burgut në fjalë.

70.7 Të burgosurit kanë të drejtë të kërkojnë këshilla ligjore rreth ankesave, procedurave të apelineve dhe për asistencën ligjore kur kërkohet për interesa të drejtësisë.

Pjesa V

Menaxhimi dhe personeli

Puna në burg si shërbim publik

71. Burgjet janë përgjegjësi e organeve publike, të ndara nga shërbimet ushtarake, policore ose hetimore.

72.1 Burgjet menaxhohen brenda një kuadri etik që njeh të drejtën për të trajtuar të gjithë të burgosurit me humanizëm dhe me respekt për dinjitetin e një qeniejeje njerëzore.

72.2 Personeli manifeston një sens të qartë të qëllimit të sistemit të burgjeve. Strukturat drejtuese japin orientimet sesi mund të arrihet sa më mirë ky qëllim.

72.3 Detyrat e personelit shkojnë përtej detyrave të rojeve të thjeshtë dhe duhet të marrin parasysh nevojën e lehtësimit të ri-integrimit të të burgosurve në shoqëri pas përfundimit të dënimit nëpërmjet programeve të kujdesit dhe ndihmës pozitive.

72.4 Personeli punon sipas standardeve të larta profesionale dhe personale.

73. Autoritetet e burgut i japin përparësi vëzhgimit të zbatimit të rregullave që lidhen me personelin.

74. Një vemendje e rëndësishme i kushtohet menaxhimit të marrëdhënieve ndërmjet personelit të burgut që punon direkt me të burgosurit dhe të burgosurve që ata kanë nën kujdes.

75. Gjatë të gjithë kohës personeli sillet mirë dhe realizon detyrat në mënyrë që të influencojë tek të burgosurit me shembullin e tij të mirë dhe të fitojë respektin e të burgosurve.

Përzgjedhja e personelit të burgut

76. Personeli përzgjidhet me kujdes, trajnohet ashtu siç duhet si në fazën pas fillimit të punës dhe në vijimësi, paguhet në nivelin e punonjësve profesionistë dhe ka një status të respektuar nga shoqëria civile.

77. Gjatë përzgjedhjes së personelit të ri, organet e burgut i kushtojnë rëndësi të madhe nevojës për integritet, trajtim human, kapacitet profesional dhe qëndrueshmëri personale për punën komplekse që u nevojitet të bëjnë.

78. Personeli profesional i burgut normalisht emërohet me kontratë të përhershme dhe ka statusin e nëpunësit civil dhe gëzon sigurimin e punës, në rastet kur vihet re sjellje e mirë, efikasitetit, shëndet i mirë fizik dhe mendor dhe një nivel i përshtatshëm arsimimi.

79.1 Pagat duhet të jenë të përshtatshme për të tërhequr dhe mbajtur një personel të kualifikuar.

79.2 Përfitimet dhe kushtet e punësimit reflektojnë natyrën e punës si pjesë e një agjencie të zbatimit të ligjit.

80. Kur është e nevojshme të merret në punë një personel me kohë të pjesshme, për të aplikohen të njëjtat kritere.

Trajnimi i personelit të burgut

81.1 Përpara fillimit të punës personeli merr pjesë në një kurs trajnimi rreth detyrave të tij të përgjithshme dhe specifike dhe atij i kërkohet të japë teste teorike dhe praktike.

81.2 Struktura drejtuese do të sigurohet që, gjatë karrierës së tyre, personeli të ketë njohuri dhe aftësi profesionale dhe t'i përmirësojë ato duke marrë pjesë në kurse gjatë shërbimit dhe programe të tjera zhvillimi që organizohen në intervale të përshtatshme.

81.3 Personeli, të cilit i duhet të punojë me grupe të veçantë të të burgosurve, si për shembull me nënshtetas të huaj, gra, të rinj ose të burgosur me të meta mendore, trajnohet posaçërisht për punën e tij të specializuar.

81.4 Trajnimi i të gjithë personelit përfshin udhëzime për instrumentat dhe standardet ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut, veçanërisht Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Konventën Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe aplikimin e Rregullave Evropiane të Burgjeve.

Menaxhimi i burgjeve

82. Personeli përzgjidhet dhe emërohet pa diskrimin seks, ngjyre, gjuhe, feje, politike ose opinioni, kombësie ose origjine shoqërore, apo diskrimin të lidhur me një pakicë kombëtare, pronësinë, lindjen ose ndonjë status tjetër.

83. Autoritetet e burgut prezantojnë sisteme të organizimit dhe menaxhimit që:

- a. sigurojnë që të burgosurit menaxhohen sipas standardeve të larta, të cilat janë në përputhje me instrumentat ndërkombëtarë dhe rajonalë të të drejtave të njeriut; dhe
- b. lehtësojnë komunikimin e mirë ndërmjet të burgosurve dhe ndërmjet kategorive të tjera të personelit në burgje individuale dhe bashkëpunim të përshtatshëm të të gjithë departamenteve, si brenda dhe jashtë burgut, që u ofrojnë shërbime të burgosurve, të cilat përqëndrohen kryesisht tek kujdesi dhe ri-integrimi i të burgosurve.

84.1 Çdo burg ka një drejtor, i cili është i kualifikuar për këtë pozicion si nga karakteri, aftësia administrative, trajnimi i duhur profesional dhe eksperiencia.

84.2 Drejtorët emërtohen në pozicione me kohë të plotë dhe i kushtojnë të gjithë kohën e tyre detyrave zyrtare.

84.3 Autoritetet e burgut sigurohen që çdo burg gjatë të gjithë kohës është në përgjegjësi të plotë të drejtorit, zëvendës drejtorit ose zyrtarëve të tjerë të autorizuar.

84.4 Nëse një drejtor është përgjegjës për më shumë se një burg, përveç tij secili burg duhet të ketë një zyrtar përgjegjës.

85. Numri i burrave dhe grave në personelin e burgut është i balancuar.

86. Ka dispozita ligjore për strukturën drejtuese për t'u konsultuar me personelin për çështje të përgjithshme, dhe, veçanërisht, për çështje që kanë të bëjnë me kushtet e punësimit.

87.1 Ka dispozita ligjore që inkurajojnë komunikimin më të mirë të mundshëm ndërmjet strukturës drejtuese, personelit, agjencive të jashtme dhe të burgosurve.

87.2 Drejtori, struktura drejtuese dhe personeli tjetër i burgut duhet të jetë në gjendje që të flasë gjuhën e përdorur nga pjesa më e madhe e të burgosurve, ose një gjuhë të kuptuar nga pjesa më e madhe e tyre.

88. Në rastet e ekzistencës së burgjeve private, aplikohen të gjitha Rregullat Evropiane të Burgjeve.

Personeli i specializuar

89.1 Personeli përfshin, brenda mundësive, një numër të mjaftueshëm specialistësh, si për shembull psikiatër, punonjës socialë dhe të mirëqënies, mësues për arsim profesional dhe trajnim fizik dhe instruktorë sporti.

89.2 Kur është e mundur inkurajohet marrja në punë me kohë të pjesshme e punonjësve të tjerë dhe e vullnetarëve për të ndihmuar në aktivitetet e burgut.

Ndërgjegjësimi i publikut

90.1 Autoritetet e burgut informojnë në mënyrë të vazhdueshme publikun rreth qëllimit të sistemit të burgjeve dhe punës së bërë nga personeli i burgut në mënyrë që të inkurajohet një kuptim më i mirë publik i rolit të burgut në shoqëri.

90.2 Autoritetet e burgut e inkurajojnë publikun të ofrojë shërbime vullnetare në burg kur është e nevojshme.

Kërkimi dhe vlerësimi

91. Autoritetet e burgut mbështesin një program kërkimi dhe vlerësimi rreth qëllimit të burgut, rolit të tij në një shoqëri demokratike dhe nivelin në të cilin ai e plotëson qëllimin e tij.

Pjesa VI

Inspektimi dhe monitorimi

Inspektimi qeveritar

92. Burgjet inspektohen rregullisht nga një agjenci qeveritare në mënyrë që të vlerësohet nëse ato administrohen në përputhje me legjislacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar dhe me parashikimet e këtyre rregullave.

Monitorimi i pavarur

93.1 Kushtet e ndalimit dhe trajtimi i të burgosurve monitorohen nga një organ ose disa organe të pavaruara, gjetjet e të cilit/cilëve do të bëhen publikë.

93.2 Organi ose organet e tilla të pavaruar inkurajohen që të bashkëpunojnë me agjencitë ndërkombëtare që kanë ligjërisht të drejtën të vizitojnë burgjet.

Pjesa VII

Të burgosurit e pagjykuar

Statusi si të burgosur të pagjykuar

94.1 Për qëllim të këtyre Rregullave, të burgosurit e pagjykuar janë të burgosurit të cilët janë të ndaluar nga një organ gjyqësor përpara se të gjykohen ose të dënohen.

94.2 Një shtet mund të zgjedhë që t'i konsiderojë të burgosurit, të cilët janë ndaluar dhe dënuar si të burgosur të pagjykuar nëse apelimet e tyre nuk kanë marrë ende përgjigje.

Qëndrimi në lidhje me të burgosurit e pagjykuar

95.1 Regjimi për të burgosurit e pagjykuar nuk influencohet nga mundësia që ata mund të dënohen për një vepër penale në të ardhmen.

95.2 Rregullat në këtë pjesë ofrojnë elementë të tjerë shtesë për të burgosurit e pagjykuar.

95.3 Gjatë trajtimit të të burgosurve të pagjykuar, organet e burgut udhëhiqen nga rregullat që aplikohen për të gjithë të burgosurit dhe i lejojnë të burgosurve të pagjykuar të marrin pjesë në veprimtari të ndryshme të cilat parashikohen në këta rregulla.

Fjetja

96. Brenda mundësive, të burgosurve të pagjykuar do t'u jepet mundësia të qëndrojnë në qeli më vete, me përjashtim të rasteve kur ata mund të përfitojnë nga qëndrimi në qeli me një tjetër të burgosur të pagjykuar ose me përjashtim të rasteve kur një gjykatë ka lëshuar një urdhër të veçantë mbi mënyrën se si një i burgosur i pagjykuar duhet të qëndrojë në qeli.

Veshja

97.1 Të burgosurit e pagjykuar lejohet të veshin rrobat e tyre nëse ato janë të përshtatshme për t'u veshur në burg.

97.2 Të burgosurit e pagjykuar që nuk kanë veshje të përshtatshme, pajisen me veshje që nuk është e njëjta me uniformën e veshur nga të burgosurit e dënuar.

Këshillimi ligjor

98.1 Të burgosurit e pagjykuar informohen plotësisht mbi të drejtat e tyre për këshillim ligjor.

98.2 Për të ndihmuar të burgosurit e pagjykuar që të përgatisin mbrojtjen dhe për t'u takuar me përfaqësuesit ligjorë ofrohen të gjitha lehtësitë e mundshme.

Kontakti me botën e jashtme

99. Me përjashtim të rastit kur ka një ndalim specifik për një periudhë të veçantë nga një organ gjyqësor në një çështje individuale, të burgosurit e pagjykuar:

- a. presin vizita dhe lejohen të komunikojnë me familjen dhe persona të tjerë në të njëjtën mënyrë si të burgosurit e dënuar;
- b. mund të presin vizita shtesë dhe kanë akses më të madh në forma të tjera komunikimi; dhe
- c. kanë akses tek librat, gazetatat dhe media të tjera.

Puna

100.1 Personave të pagjykuar u ofrohet mundësia për të punuar, por nuk u kërkohet të punojnë.

100.2 Nëse personat e pagjykuar vendosin të punojnë, për ta aplikohen dispozitat e pikës 26, duke përfshirë dhe dispozitat e lidhura me shpërblimin.

Akresi në regjimin e të burgosurve të dënuar

101. Nëse një i burgosur i padënuar kërkon që të lejohet të ndjekë regjimin për të të burgosur të dënuar, organet e burgut pranojnë këtë kërkesë sa më shpejt të jetë e mundur.

Pjesa VIII

Objektivi i regjimit për të burgosurit e dënuar

102.1 Përveç rregullave që aplikohen për të gjithë të burgosurit, regjimi për të burgosur të dënuar hartohet për t'u bërë të mundur atyre që të bëjnë një jetë të përgjegjshme dhe pa krime.

102.2 Burgimi, dmth heqja e lirisë, është një dënim në vetvete, dhe, si rezultat, regjimi për të burgosurit e dënuar nuk duhet të përkeqësojë vuajtjen e vetë burgimit.

Zbatimi i regjimit për të burgosurit e dënuar

103.1 Regjimi për të burgosurit e dënuar fillon sapo dikush pranohet në burg me statusin e një të burgosuri të dënuar, në përjashtim të rasteve kur ai (regjimi) ka filluar më parë.

103.2 Sapo të jetë e mundur pas pranimi, përgatiten raporte për të burgosurit e dënuar duke përfshirë situatat personale, planet e propozuara të dënimit për secilin prej tyre dhe strategjitë për përgatitjen e lirim të tyre..

103.3 Të burgosurit e dënuar inkurajohen të marrin pjesë në përgatitjen e planeve të tyre individuale.

103.4 Aq sa të jetë praktike, këto plane përfshijnë:

- a. punën;
- b. arsimin;
- c. aktivitete të tjera; dhe
- d. përgatitjen për lirim.

103.5 Puna sociale, kujdesi mjekësor dhe psikologjik mund të përfshihen gjithashtu në regjimet e personave të dënuar.

103.6 Sistemi i lejes së burgut është pjesë integrale e regjimit të përgjithshëm të të burgosurve të dënuar. .

103.7 Të burgosurit që dëshirojnë të bëjnë këtë gjë mund të përfshihen në një program për rikuperimin e drejtësisë dhe për ndreqjen e shkeljeve të tyre.

103.8 Një vëmendje e veçantë i kushtohet hartimit të planeve dhe përcaktimit të regjimeve të veçanta të dënimit për të dënuarit me burgim të përjetshëm dhe për të burgosur të tjerë të dënuar me periudhë të gjatë.

Aspektet organizative të burgosjes së të burgosurve të dënuar

104.1 Aq sa të jetë e mundur dhe në përputhje me pikën 17, përdoren burgje të veçanta ose seksione të veçanta të një burgu për të bërë më të lehtë menaxhimin e regjimeve të ndryshme për kategori specifike të të burgosurve.

104.2 Ka procedura të veçanta për përcaktimin dhe rishikimin e rregullt të planeve individuale të dënimit të të burgosurve pas marrjes parasysh të raporteve të duhura, konsultimeve të personelit përkatës me të burgosurit, të cilët duhet të përfshihen sa më shumë të jetë e mundur..

104.3 Raporte të tilla gjithmonë përfshijnë raporte nga personeli drejtpërdrejt përgjegjës për të burgosurin në fjalë.

Puna nga të burgosurit e dënuar

105.1 Një program sistematik pune synon të kontribojë në plotësimin e objektivave të regjimit për të burgosurit e dënuar.

105.2 Të burgosurve të dënuar që nuk e kanë arritur normën normale të pensionit mund t'u kërkohet të punojnë, në varësi të aftësisë së tyre fizike dhe mendore, dhe sipas përcaktimeve të ekspertit mjekësor.

105.3 Nëse të burgosurve të dënuar u kërkohet të punojnë, kushtet e punës janë në përputhje me standardet dhe kontrollet që aplikohen në komunitetin jashtë burgut.

105.4 Kur të burgosurit e dënuar marrin pjesë në arsim ose në programme të tjera gjatë orëve të punës si pjesë e regjimeve të tyre të planifikuara, ata shpërblehen sikur të kishin qenë duke punuar.

105.5 Në rastin e të burgosurve të dënuar, pjesë e të ardhurave të tyre ose e kursimeve të tyre nga këto aktivitete mund të përdoret për qëllime ndreqëse nëse urdhërohet nga një gjykatë ose nëse i burgosuri në fjalë dëshiron t'i përdorë për këto qëllime.

Arsimimi i të burgosurve të dënuar

106.1 Pjesë kyçe e regjimeve të të burgosurve të dënuar është një program sistematik arsimi, duke përfshirë dhe aftësitë trajnuese, me objektivin e përmirësimit të nivelit të përgjithshëm të arsimit si dhe qëllimin e të pasurit të një jete të përgjegjshme dhe pa krime.

106.2 Të gjithë të burgosurit e dënuar inkurajohen të marrin pjesë në programe edukative dhe trajnuese.

106.3 Programet edukative për të burgosurit e dënuar përgatiten në varësi të zgjatjes së parashikuar të qëndrimit të burg.

Lirimi i personave të dënuar

107.1 Të burgosurit e dënuar ndihmohen para lirimit nga procedura dhe programe të veçanta që u lejojnë atyre të bëjnë tranzicionin nga jeta në burg në jetën që udhëhiqet nga ligji në komunitet.

107.2 Në rastet e të burgosurve me dënime më të gjata, merren masa për të siguruar një kthim gradual në jetën në shoqërinë e lirë.

107.3 Ky qëllim mund të arrihet nëpërmjet një programi paralirimi në burg, ose nëpërmjet lirimit të pjesshëm ose të kushtëzuar me mbikqyrje, të kombinuar me një mbështetje efektive shoqërore.

107.4 Autoritetet e burgut punojnë ngushtë me shërbimet dhe agjencitë që supervizojnë dhe ndihmojnë të burgosurit e liruar për t'u lejuar atyre të rivendosin pozicionin e tyre në shoqëri, në veçanti në lidhje me jetën në familje dhe punësimin.

107.5 Përfaqësuesve të shërbimit shoqëror ose të agjencive duhet t'u ofrohet akses i nevojshëm në burg dhe tek të burgosurit në mënyrë që atyre t'u lejohet të ndihmojnë në përgatitjet për lirim dhe planifikim të programeve të kujdesit pas lirimit.

Pjesa IX

Rishikimi i Rregullave

108. Rregullat Evropiane të Burgjeve do të rishikohen rregullisht.